

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE MJEDISIT,
DEPARTAMENTI I HORTIKULTURËS DHE ARKITEKTURËS SË
PEIZAZHIT

RREGULLORE PËR PËRGATITJEN E TEZËS
SË DIPLOMËS

Bachelor në Inxhinieri agrare: Profili Arkitekturë Peizazhi

Tiranë 2022

KREU I. Modalitetet e Pranimit për tezën e Diplomës

1. Hyrje

Teza e Diplomës është komponenti kryesor përfundimtar i programit të studimeve në programin Bachelor në Inxhinieri agrare, Profili “Arkitekturë Peizazhi”. Në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, teza e diplomës në këtë program vlerësohet me 5 kredite (ECTS).

Teza e diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një projekti ose studimi me karakter përgjithësues në fushat e Arkitekturës së Peizazhit si dhe disiplinave të lidhura drejtpërdrejt me formimin e marrë gjatë zhvillimit të programit të studimit.

Teza e diplomës përmban një sërë detyrash e kërkesash, mënyra e shtrimit e të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete studimore e projektuese, të tregojë aftësitë e tij profesionale dhe kompetencën për të kryer projekttime ose studime në fushën e Arkitekturës së Peizazhit.

Teza e diplomës është e lidhur me disa disiplina të përafërta dhe zakonisht është individuale por mund të jetë edhe kolektive (dy-tre studentë), në rastet e projekteve ose tezave studimore komplekse. Në rastet e punimeve kolektive, studentët duhet të të ndajnë qartësisht çështjet që do të trajtojnë, duke respektuar një ndarje afërsisht të barabartë të volumit të punës që do të kryejnë. Secili prej studentëve duhet të paraqesë pjesën e tij të punimit si një dokument i veçantë.

2. Procedura për fillimin e procesit të tezës së diplomës

Çdo student i programit të studimit “Arkitekturë peizazhi” dorëzon kërkesë në sekretarinë e departamentit për pranimin në procesin e tezës së diplomës. Sekretaria pergatit listen e studentëve që kualifikohen për të qenë pjesë e procesit të diplomës. Kjo listë miratohet nga GMK Arkitekturë peizazhi dhe dokumentohet në protokoll.

3. Rregullat bazë për kualifikimin në procesin e tezës së diplomës

Në mënyrë që studentët të përfshihen në procesin e përgatitjes së tezës së diplomës ata duhet:

- a. Të paraqesin një propozim teme për punimit që do të kryhet pranë drejtuesit të Grupit Mësimor Kërkimor “Arkitekturë Peizazhi”.
- b. Të ndjekin konsultat me Udhëheqësin e diplomës dhe të kenë kryer konsultimet e organizuara me Grupin Udhëheqës të Diplomave.
- c. Të kenë kryer me sukses të 3 kontrollat e zhvilluara me Komisionin e Diplomimit i cili kontrollon volumin e punës së kryer nga studenti dhe cilësinë e saj.

4. Afatet e realizimit të diplomës

Procesi i diplomës realizohet në disa faza si më poshtë:

- a. *Faza përgatitore - orientimi dhe shqyrtimi i listës së studentëve të kualifikuar.*

Në këtë fazë jepen detaje, informacione dhe orientime rreth procesit të tezës së diplomës. Të gjithë studentët e vitit të fundit akademik duhen të jenë të pranishëm në këto aktivitete. Studenti jo më vonë se një javë nga organizimi i fazës përgatitore dorëzon në sekretarinë mësimore kërkesë për fillimin e procedurës së tezës së

diplomës. Sekretaria mbledh kërkesat dhe verifikon plotësimin e kritereve të kualifikimit.

b. Faza e parë- paraqitja dhe miratimi i temës së punimit për tezën e diplomës

Studentët të cilët i kanë ndjekur konsultat përgatitore dhe janë kualifikuar në procesin e tezës së diplomës duhet të dorëzojnë pranë Grupit mësimor kërkimor “Arkitekturë peizazhi”, brenda javës së parë pas fillimit të semestrit të VI-të, *projekt-propozimin për temën e diplomës* që duhet të jetë një material me shkrim minimumi 2 faqe format A4, ku propozojnë temën, objektivin, metodologjinë, rastin studimor, kalendarin, afatet kohore të synuara, literaturën e konsultuar paraprakisht etj, në përputhje me afatet e përcaktuara me kordinatorin e Diplomës. Pedagogët në bashkëpunim me departamentin organizojnë takime me studentët dhe vendosin në lidhje me Temat e pranuar ose sugjerohen tema të tjera brenda javës së dytë pas fillimit të Semestrit të VI-të.

c. Faza e dytë – Pjesëmarrje në kontrollet e organizuara nga Komisioni.

Komisioni i pedagogëve për kontrollet miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Drejtuesit e diplomës organizojnë kalendarin e kontrolleve për diplomat, ku marrin pjesë antarët e departamentit, dhe shpall datat e kontrolleve, minimalisht 2 javë përpara. Sipas orientimeve të mëposhtme

- i. Kontroll i parë javën e parë të Prillit.
- ii. Kontroll i dytë javën e parë të Majit.
- iii. Kontroll i tretë javën e parë të Qershorit.

Studentet kanë detyrim të marrin pjesë në të 3 kontrollet.

d. Faza e tretë- Dorëzimi i punës finale dhe mbrojtja e diplomës

Tema e diplomës është organizuar në formatin “Prezantim përpara Komisionit” të diplomimit në Arkitekturë Peizazhi në përputhje me orarin e përcaktuar nga sekretaria mësimore. Ky prezantim i nënshtrohet të gjitha detyrimeve dhe termave të referencës të përshkruara gjatë fazës përgatitore.

- i. Universiteti Bujqesor i Tiranës organizon sezone për mbrojtjen e diplomave. Datat e zhvillimit të mbrojtjes sipas sezoneve përkatëse, përcaktohen nga Dekanati.
- ii. Përgatitja dhe paraqitja e punimit të diplomës bëhet sipas normave të përcaktuara nga kjo rregullore dhe rregullave të tjera të vendosura nga fakulteti dhe ndjek procedurat e miratuara nga Dekani përpara se ai të mbrohet në komisionin e diplomimit.
- iii. Të gjithë studentët që synojnë mbrojtjen e temës duhet të marrin aprovimin e udheheqesit.
- iv. Punimi i diplomës mbrohet përpara një komisioni të posaçëm, i përbërë nga pedagogë efektivë por në raste të caktuara mund të ftohen edhe staf i jashtëm, të miratuar nga departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit. Kryetari i komisionit caktohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Ai respekton në çdo rast, për secilin diplomant procedurën dhe rregullat përkatëse të vendosura nga Dekanati.
- v. Komisioni i Diplomimit funksionon kur janë jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij.

vi. Mbrojtja e diplomës është publike.

5. Grupi Udhëheqës i Diplomave dhe Oponenti

Në grupin udhëheqës të tezave të diplomave përfshihen udhëheqësit e studiove të zhvilluara gjatë procesit mësimor si dhe anëtarë të tjerë të miratuar. Grupi Udhëheqës i Diplomave përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe ka këto përgjegjësi:

- a. konsulton programin e punës së diplomantit, në përputhje me afatet e parashikuara në përgatitjen e Diplomës. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të tezës së diplomës në sezonin e caktuar.
- b. përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentin.
- c. mban shënimet përkatëse në lidhje me ecurinë e studentit në punimin e temës së diplomës, duke i kushtuar kujdes të veçantë shmangjes së fenomenit të plagjiaturës. Grupi Udhëheqës i Diplomave realizon orët e konsultimeve me studentin sipas ngarkesës të përcaktuar në programin vjetor.
- d. Oponenti i një studentit përcaktohet nga përgjegjësi i Departamentit. Oponenti jep vlerësimin me shkrim i cili përbën 20% të vlerësimit përfundimtar. Oponenti është një format vlerësimi me shkrim dhe notë finale (bashkëlidhur Formatin i vlerësimit të oponentit).

KREU II. Struktura dhe Forma e Paraqitjes së Temës së Diplomës

1. Tema e diplomës duhet të përbëhet nga rreth 25-30 faqe A4 të shtypura nga të dyja anët, nga të cilat jo më pak se 20 faqe duhet të jenë tekst dhe 3 flete A1 shtesa për postera prezantuese. Të njëjtët postera duhet të jenë të printuar edhe në fletë A3 dhe t'i bashkangjiten si aneks materialit tekst të printuar.

2. Kopertina e temës së diplomës duhet të jetë sipas standardit të ofruar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës. Në krye të kopertinës vendoset stema e “Universitetit Bujqësor të Tiranës”. Mbi sfondin e njëtrajtshëm gërmat duhet të jenë të zeza, në madhësinë e dhënë tek modeli i kopertinës;

tipi i gërmeve: *ARIAL* (sipas formatit bashkëngjitur)

3. Faqet e temës së diplomës duhet të formatohen si vijon:

- a. Tipi i gërmeve: *Times New Roman*
- b. Madhësia e shkronjave në titull: 16
- c. Madhësia e shkronjave normale të tekstit 12
- d. Hapësira midis rreshtave: 1

4. Struktura e tezës së diplomës duhet të jetë si më poshtë:

- Dedikimet dhe mirënjohjet
- Përmbledhje/abstrakti në shqip dhe anglisht
- Tabela e përmbajtjes
- Shkurtime

- Lista e tabelave dhe ilustrimeve

1. Hyrje

- 1.1 Sfondi i përgjithshëm mbi temën që trajtohet
- 1.2 Problemi kërkimor i evidentuar
- 1.3 Qëllimi, Pyetjet hulumtuese dhe Objektivat
- 1.4 Kontributi praktik i diplomës
- 1.5 Struktura e Tezës së diplomës (përshkrim përmbledhës i kapitujve të tezës)

2. Metodologjia.

- 2.1 Metoda 1
- 2.2 Metoda 2 (nëse ka)

3. Kuadri Teorik

- 2.1 Konceptet Teorike që përdoren (mund të ndahen në disa nën/seksione)
- 2.2 Raste studimore ose shembuj ilustrues nga vende të tjera dhe ndërlidhja me teorinë dhe rastin e paraqitur në punim.
- 2.3 Vlerësime dhe përfundime të kuadrit teorik, përzgjedhur për tezën.

4. Analiza e Rezultateve dhe diskutimi i tyre

- 4.1 Parashtrimi i Situatës së Përgjithshme, vendi i projektit, përdoruesit, analiza e tyre.
- 4.2 Parashtrimi i të dhënave të mbledhura dhe programi i projektit.
- 4.3 Argumentimi i zgjidhjes projektuese.
- 4.4 Projekti paraprak
- 4.5 Projekti përfundimtar

5. Përfundime dhe Rekomandime

6. Literatura

Lista e plotë e literaturës së përdorur.

7. Shtojca

Pjesë e shtojcave mund të jenë materiale të ndryshme të tilla si: formularë dhe pyetësorë për anketime; formular pyetesori për intervista; transkripte intervistash; ditar vëzhgimesh në terren; materiale grafike ose analitike të paparaqitura në tekst etj.

KREU III. Dokumentimi i Tezës së Diplomës

1. Nëse punimi i diplomes ka fletë grafike për t'u paraqitur në mbrojtjen e diplomës atëhere:

- a. Numri i fletëve grafike për t'u paraqitur në mbrojtjen e diplomës është jo më shumë se 10 (dhjetë).
- b. Fletët grafike për prezantim duhet të jenë të printuara në formatin A1.

- c. Fletët grafike duhet të kenë të njëjtin orientim, të gjitha vertikale ose të gjitha horizontale, në varësi të mënyrës që studenti gjykon më të përshtatshme për të paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë të gjitha potencialet e projektit.
- d. Fletët grafike duhet të kenë logon e Universitetit Bujqësor të Tiranës si dhe të përmbajnë:
 - i. shkrimin “Universiteti Bujqësor i Tiranës ”,
 - ii. vitin akademik
 - iii. titullin dhe nëntitullin e tezës së diplomës
 - iv. titullin e fletës
 - v. emrat e Grupit Udhëheqës/udheheqesit të Diplomës
 - vi. emrin e studentit
 - vii. numrin e faqes
- e. Logo-ja dhe shkrimet e mësipërme duhet të jenë të vendosura në të njëjtin pozicion në të gjitha fletët grafike.

2. Prezantimi në powerpoint

- a. Në prezantimin në poëerpoint duhet të tregohen të gjitha tablotë përfundimtare të përshkruara më sipër.
- b. Studenti është i lirë të shtojë të gjitha materialet e tjera si dhe thellimet e ndryshme të tablove që ai i gjykon të nevojshme për analizimin dhe përshkrimin e punës së tij (grafikë, video, statistika etj).

3. Dokumentimi i punës në DVD.

Në DVD-në e dorëzuar do të përfshihen:

- a. Prezantimi poëerpoint i sipërpërmendur
- b. File-i origjinal i punimit në format .PDF (sipas standartit të dhënë më parë)
- c. Abstrakt prej 400 fjalësh i punimit në format, PDF Anglisht dhe shqip.
- d. Nëse ka, file-t dixhitale të fletëve grafike përfundimtare.

KREU IV. Mbrojtja e Tezës së Diplomës

1. Mbrojtja e Diplomës realizohet sipas sezoneve të përcaktuara nga dekanati i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit. Studenti i cili ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe ka kryer kontrollet e detyrueshme me Komisionin por nuk e ka kryer mbrojtjen e diplomës gjatë sezonit të radhës, i lind e drejta ta mbrojë diplomën në sezonin pasardhës. Data e zhvillimit të mbrojtjes përcaktohet nga Dekani. Mbrojtja e tezës realizohet para “Komisionit të Diplomimit” të ngritur nga Departamenti pasi studentit ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare. Studenti 10 ditë para datës së mbrojtjes së temës duhet të paraqesë pranë departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit dokumentat e mëposhtme:

- a. vërtetim nga sekretaria mësimore që studentit ka shlyer të gjitha detyrimet akademike përveç diplomës.

- b. deklaratë personale ku deklaron se punimi i tij është origjinal dhe respekton të drejtat e autorit dhe rregullat ndërkombëtare dhe të Universitetit Bujqësor të Tiranës për pronësinë intelektuale .
- c. dy kopje të tezës së diplomës të printuar dhe të lidhur si libër.
- d. një poster përmbledhës në version elektronik A2 me fjalë dhe grafikë, që përmbledh dhe promovon idetë e punimit, të projektit dhe gjetjet e tij, i cili do të publikohet në websitin e Universitetit Bujqësor të Tiranës në rubrikën përkatëse.
- e. vlerësimin e Grupit Udhëheqës të Diplomave.
- f. Kontrolli i plagjaturës, do të zhvillohet në gjithë procesin e punës (nga udhëheqësi, komisioni i dëgjësave, komisioni i pranimi, komisioni i mbrojtjes) dhe për rastet kur është e nevojshme ngrihet një komision i posaçëm përpara mbrojtjes së diplomës.

2. Ditën e caktuar për mbrojtjen e temës studenti paraqitet para Komisionit me dokument identifikimi dhe me anë të një prezantimi prej 20 minutash ai përshkruan punimin e realizuar.

3. Komisioni i Diplomimit e vlerëson studentin mbi bazën e prezantimit, punës së realizuar, mendimit të Grupit Udhëheqës të Diplomave dhe oponentit, duke marrë në konsideratë edhe ecurinë gjithëvjetrore të studentit.

4. Nota e mbrojtjes së diplomës është mesatarizim i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit

5. Diplomati e përfunduara dhe të vlerësuara nga Komisioni i Diplomimit janë pronë e Universitetit Bujqësor të Tiranës. Nga dy kopjet e diplomave njëra mbetet në bibliotekë dhe një kalohet në arkivë.

Literatura

Burimet e literaturës së përdorur duhet të renditen sipas alfabetit në bazë të mbiemrit të autorit të parë. Literatura duhet të citohen në tekst me numrin e listës së tyre në kllapa katrore. Të gjitha referencat e cituara në tekst, duhet të verifikohen në seksionin Literatura dhe anasjelltas, dhe të jenë të plota (autorët, viti, titulli, revista, vëllimi, faqet, etj.). Emri i revistës duhet të shkurtohet në përputhje me formularin e miratuar nga ISI Web of Science.

Vetëm artikujt që janë botuar ose janë miratuar për botim duhet të përfshihen në këtë seksion. Punimet e dorëzuara për botim por të papranuara ende, abstraktet, komunikimet personale, të dhënat e pabotuara dhe adresat e internetit duhet të citohen brenda tekstit në kllapa.

Date: Shkurt 2022